

Zhdukja e tij është evidentuar në listën e të zhdukurve të KNKK-së dhe lënda e tij e mban numrin rendor BLG-804800-01.

**Burimet:** deklarata S. A, FDH-13578; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; SMIP, *Teroristički...*, III,912; ICTY, IT-04-84 (R.Haradinaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 03.04.2008, [http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int\\_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-\(-IT-04-84-\).](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaIReforma&int_cid=124&cat=Transkripti/Predmet-Haradinaj-i-drugi-(-IT-04-84-).)

### Fazli (Hazir) Mazrekaj

(1929, shqiptar nga Vokshi/Vokša, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, shtatë fëmijë)

Fazliu i moshuar ka jetuar në Voksh/Vokša me djalin e madh Metën dhe familjen e tij. Për shkaqe sigurie, nga mesi i qershorit të vitit 1998, ai kaloi te e bija, Sofe Golaj, në fshatin Sheremet/Šeremet [Gjakovë/Đakovica]. Kur më 11.08.1998, forcat serbe filluan të bombardonin Sheremetin/Šeremet, familja e Sofes kaloi në Gjakovë/Đakovica, ndërkaq Fazliu ka mbetur vetëm në shtëpi. Ishte kjo hera e fundit kur atë e panë të gjallë. Pas tri ditësh, një i afërm ka shkuar në Sheremet/Šeremet për ta tërhequr Fazliun në Gjakovë/Đakovica, por nuk e kishte gjetur në shtëpi. Familja e ka paraqitur zhdukjen e tij. Vajza e Fazliut ka mësuar në vitin 2001 nga një grua nga Juniku/Junik, se ajo e kishte parë Fazliun në fund të gushtit 1998 në një shkollë në Deçan/Deçane, ku policia e mbante një grup të personave të moshuar. Sipas fjalëve të kësaj gruaje, atë policia e kishte liruar nga shkolla pas dy javësh, por Fazliu ka mbetur atje. Fati i tij nuk është ndriçuar ende. Në listën e të zhdukurve të KNKK-së, lënda e Fazliut është evidentuar me numrin BLG-803263-01.

**Burimet:** deklarata S.G, FDH-18695; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

### Sadri (Adem) Zukaj

(1932, shqiptar nga Belegu/Beleg, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, i martuar)

Sadriu ka mbetur në Beleg me djalin e vëllait, pasi që i vëllai Brahimi me familjen e të birit e kishin braktisur fshatin në

gusht të vitit 1998, për shkak të sulmeve të njëpasnjëshme të forcave serbe. Në fillim të shtatorit të vitit 1998, Sadriu kishte shkuar të disa miq në fshatin Dashinoc/Daşinovac. Në muajin dhjetor të vitit 1998, Brahimi kishte mësuar se trupi i Sadriut ishte gjetur në bunarin e familjes Vishaj në Dashinoc/Daşinovac. Në dhjetor të vitit 1998, familja i ka bartur mbetjet mortore të Sadriut në varrezat e fshatit Beleg, ku ai edhe është varrosur.

**Burimi:** deklarata H. Z, FDH-17886.

### Kadri (Selim) Latifaj

(6.06.1979, shqiptar nga Prilepi/Prilep, komuna e Deçanit/Deçani, pjesëtar i UÇK-së)

Kadriu ka aderuar në UÇK më 2.04.1998. Disa herë kishte shkuar në Shqipëri për të transportuar armatimet në Kosovë. Në datën 2.09.1998, së bashku me bashkëluftëtarët Binakun, Shabanin dhe Arsimin, ai ka shkuar për të vëzhguar terrenin në rajonin e fshatit Prilep. Atje u ndeshën me pjesëtarët e forcave serbe. Kadriu ka rënë në këtë betejë.

**Burimet:** J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

### Fetah (Lush) Mazrekaj

(8.04.1944, shqiptar nga Prilepi/Prilep, komuna e Deçanit/Deçani, mësues, shtatë fëmijë)

### Hedije (Zukaj Sadri) Mazrekaj

(1950, shqiptare nga Prilepi/Prilep, komuna e Deçanit/Deçani, amvise, shtatë fëmijë)

Fetahu dhe Hedija kanë jetuar në fshatin Prilep. Para lufte, Fetahu punonte si mësues në shkollën fillore Bac në Deçan/Deçane. Më vonë, u punësua si rojë nate në shkollën fillore Sylejman Vokshi në fshatin Prilep. Nga fundi i prillit të vitit 1998, Fetahu dhe Hedija u zhvendosën në fshatin Beleg për shkaqe sigurie. Tri javë më pas dhe pas sulmit të forcave serbe mbi fshatin, Fetahu dhe Hedija, së bashku me fëmijët e tyre, kaluan së pari në fshatin Ratish/Ratiš, e më pas në Isnji/Istinić. Në datën 7.09.1998, Fetahu, Hedija dhe djali Lushi shkuan te farefisi i tyre në fshatin Beleg për të bërë një telefonatë në Gjermani, ku qëndronin disa nga djemtë e Fetahut. Një